



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale**  
**Komisioneri**

---

Nr. 24/2 Prot.

Tiranë, më 4/F/2011

**Lënda:** Rekomandim për Spitali Amerikan **UNIVERS-ALB Sh.A.**

**REKOMANDIM**

Mbështetur në Ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr.211, datë 11.09.2008 “Për zgjedhjen e komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe nr 225, datë 13.11.2008 “Për miratimin e strukturës organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale”, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit, Spitali Amerikan **UNIVERS-ALB Sh.A.**,

**KONSTATOVA**

Më datë 04/05/.2011 nga grupi i inspektimit të Zyrës së Komisionerit është zhvilluar kontrolli administrativ pranë kontrolluesit, Spitali Amerikan **UNIVERS-ALB Sh.A.**, me cilësinë si kontrollues që mbledh dhe përpunon të dhëna personale në ushtrim të qëllimit dhe aktivitetit të tij, me objekt:

- Të dhënat personale që përpunohen (kategoritë e subjekteve, pacientë, punonjës etj.).
- Mbrojtja e të dhënave personale, kriteret ligjore për përpunimin, përpunimi i të dhënave sensitive, transferimi ndërkombëtar i të dhënave të parashikuara në nenet 5,6,7,8,9 të ligjit 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.
- Si zbatohen të drejtat e subjekteve të të dhënave personale të parashikuara në nenet 12, 13, 14, 15, 16, 17, të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.
- Plotësimi i detyrimit për të njoftuar pranë zyrës së Komisionerit në lidhje me të dhënat personale që përpunohen (neni 21).
- Masat për sigurinë e të dhënave personale (neni 27).
- A përpunohen të dhëna personale nëpërmjet sistemeve të kamerave (CCTV), nëse ka tabela informuese?

Komisioneri "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" pasi shqyrtoi procesverbalin e inspektimit administrativ të mbajtur me këtë rast si dhe provat e administruara vëren se:

1. Lidhur me detyrimin ligjor për njoftim sipas nenit 21, të Ligjit nr. 9887, dt 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", u konstatua se, kontrolluesi Spitali Amerikan **UNIVERS-ALB Sh.A**, e ka përmbushur këtë detyrim, por me mangësitë si poshtë:
    - Kontrolluesi tek **Rubrika 6**, "**Kategoritë e të dhënave personale që përpunohen**," nuk ka plotësuar, nënrubrikën "Të dhënat biometrike".
    - Kontrolluesi tek **Rubrika 7**, "**Të dhënat sënsitive që përpunohen**", nuk ka plotësuar, pikën 7.2, "Përpunohen të dhëna sensitive" si dhe nënrubrikën "Gjendja penale".
    - Kontrolluesi tek **Rubrika 8**, "**Marrësi i të dhënave personale**", nuk ka deklaruar që, "Ka përhapje të dhënash", ndërkohë që ka përhapje të dhënash; për pasojë nuk janë plotësuar, rubrikat 8.2.1 "Subjekti i marrës", dhe 8.2.2 "Qëllimi i përhapjes".
    - Kontrolluesi tek **Rubrika 9**, "**Transferimi ndërkombëtar i të dhënave personale**", ka deklaruar se nuk kryen të tilla transferime, ndërkohë që sipas rubrikës 9.2.3, "Frekuenca e transferimeve" ka deklaruar se kjo frekuencë ndodh 1 herë. Sa më sipër kjo rubrikë duhet riformuluar dhe kontrolluesi duhet të deklaroj në mënyrë të qartë dhe të plotë nëse kryen ose jo transferime ndërkombëtare, vendet ku kryhet këto transferime, frekuenca etj. Pra të nënplotësojë, të gjitha nënrubrikat e tjera në lidhje me transferimet ndërkombëtare të të dhënave që kryen.
    - Kontrolluesi tek **Rubrika 10** ka plotësuar se ka dokument të qartë për mbrojtjen e të dhënave, tek **nënrubrika 10.1** por, nga grupi i kontrollit u konstua që nuk ka një dokument të tillë; Ndërkohë në nënrubrikën 10.1, gjithashtu është deklaruar se, ka rregulla që lejojnë kontrollin e aksesit në përpunimit e të dhënave personale, ndërkohë këto rregulla nuk janë të përcaktuara qartë.
  - Në këtë rast është kryer detyrimi ligjor për njoftim sipas nenit 21, të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", "*...Çdo kontrollues duhet të njoftojë komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i qëllimit të përpunimit, të njoftuar më parë*" por, nuk janë plotësuar në mënyrën e duhur të gjitha rubrikat e këtij formulari, neni 23 i Ligjit "*Komisioneri shqyrton të gjitha njoftimet dhe kur njoftimi është i pamjaftueshëm, ai urdhëron kontrolluesin të plotësojë të dhënat, duke përcaktuar edhe afatin kohor*".
2. U konstatua se, në Rregulloren e Brendshme të kontrolluesit Spitali Amerikan, ka vetëm një nënrubrikë në rubrikën "**Rregulla të përgjithshme të etikës në shërbimin civil**", paragrafi i dytë, sipas të cilës: "*të gjithë punonjësit të mos përdorin as të lejojnë të përdoret informacioni që ata marrin gjatë kryerjes së tyre, në dobi të interesit privat të tyre apo të personave të tjerë, nëse ky informacion është konfidencial ose nuk është i hapur apo i publikuar*".  
Përveç rregullore, "**Rregulla të përgjithshme të etikës në shërbimin civil**", ky spital ka dhe "**Rregullore e Funkcionimit të Spitalit Amerikan**", sipas të cilit udhëzohen nga

pikëpamja profesionale mjekesore, stafi mjekësor për veprimtarinë brenda spitalore, në pavionet, laboratorët, qendrat e urgjencës etj. Në volumin e kësaj rregullore, ku përveç rasteve të trajtimit mbi sëmundshmëri të ndryshme, përfshiheshin trajtimet edhe mbi sëmundjet dhe infeksionet seksualisht të transmetueshme, si HIV/AIDS, sifilizi, klamidia, gonorea, herpesi, papiloma virusi etj, nuk janë parashikuar, masa dhe rregulla për mbrojtjen e të dhënave personale sensitive të të prekurve, nga këto të fundit. Është parashikuar një rubrikë rreth informimit, edukimit dhe komunikimit për parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS, në të cilën është parashikuar paragrafi 2/c, si më poshtë vijon:

*“2. Informimi, edukimi dhe komunikimi për parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS-it, duhet të jetë:*

*c) jodiskriminues dhe pa keqpërdorur informacionet ose pamjet e personave që jetojnë me HIV/AIDS”.*

Në rregulloret e brendshme ky kontrollues nuk ka rregulla të qarta në lidhje me kohëzgjatjen e mbajtjes së të dhënave personale, sipas qëllimit për të cilin këto të dhëna janë mbledhur. Rregullat për mbrojtjen e të dhënave personale të pacientëve apo të punonjësve janë shumë sporadike, dhe në ato raste ku përmenden klauzola mbi konfidencialitetin, më së shumti janë në funksion të interesave të kontrolluesit.

Ky kontrollues duhet të veprojë sipas një rregulloreje të mirëfilltë dhe enkas për mbrojtjen e të dhënave personale. Kjo diktohet edhe nga numri shumë i madh i të dhënave personale që disponon, të dhëna që në një pjesë të rëndësishme të tyre janë të kategorisë sensitive që lidhen me gjëndjen shëndetësore të pacientëve.

3. Kontrolluesi, Spitali Amerikan **UNIVERS-ALB Sh.A** monitoron ambientet e veta me anë të sistemit të kamerave CCTV për vëzhgim dhe regjistrim të imazheve me qëllim *“Ruajtjen dhe sigurinë”* e pronës. Sistemi është i vendosur në ambientet e departamentit të teknologjisë dhe informacionit dhe menaxhohet nga stafi i kësaj drejtorie. Ambientet e monitoruara me anë të sistemit CCTV janë: recepsioni, koridoret, sallat e operacionit si dhe parkingu. Sistemi funksionon në varësi të kapacitetit si dhe procedurës ku, regjistrimi i ditës së re fshin regjistrimin e ditës më të vjetër në mënyrë sekuenciale.

Nuk ka një dokument në të cilin shprehet qartë qëllimi i përdorimit të një pajisje të tillë **përpunimi të dhënash personale. Nuk disponohet ndonjë rregullore apo udhëzim në lidhje me përdorimin e sistemit CCTV ku të jenë të përcaktuar koha e ruajtjes së imazheve si dhe ambientet e monitoruara, sidomos në sallat e operacioneve.**

Gjithashtu, ky kontrollues ka në përdorim sistem të kamerave (CCTV) për mbikqyrjen e ambienteve. **U konstatua se ishin vendosur tabela parapajmeruese në disa nga ambientet e monitoruara me anë të sistemit CCTV por ambientet e spitalit Amerikan (qëndror) nuk ishin të pajisura me të tilla tabela.** (në kundërshtim me nenin 18 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”*).

- Në këtë rast nuk është zbatuar neni 27 pika c i ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”*... *“udhëzon operatorët pa përjashtim, për detyrimet që kanë, në përputhje me këtë ligj dhe rregulloret e brendshme për mbrojtjen e të dhënave, përfshirë edhe rregulloret për sigurinë e të dhënave”*, dhe

neni 18 i ligjit të sipërcituar...”*Kontrolluesi, kur mbledh të dhëna personale duhet ta informojë subjektin e këtyre të dhënave*”..

Gjithashtu u konstatua se, ky kontrollues mban për një afat kohor të pacaktuar, dosje të stafit administrativ dhe atij mjekësor, edhe pas ndërprerjes së marrdhënieve të punës me këtë kontrollues.

- Në këtë rast nuk është zbatuar neni 5 pika1/d i ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*”... “*Në mbajtjen në atë formë, që të lejojë identifikimin e subjekteve të dhënave për një kohë, por jo më tepër sesa është e nevojshme për qëllimin, për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar më tej*”.

4. U konstatua se, të gjitha të dhënat e mbledhura për pacientët dhe që depozitohen në arkivë përfshihen në Kartelën Klinike të pacientit në formën e një dosjeje, dhe arkivohen në arkivat respektive të spitaleve. Kur mjekut i nevojitet kartela e një pacienti, kjo kartelë klinike, e cila në jo pak raste është shume voluminoze, i përcillet mjekut, nëpërmjet punonjësës së recepsionit, të cilës i jepet nga punonjësja e arkivës.

Këto Kartela Klinike të pacientëve, dorëzohen dhe kthehen në arkivë të dokumentuara në një rregjistër për hyrje dhe dalje të dosjeve. Por, ndërkohë dosjet nuk janë të pajisura me një proces verbal, për të evidentuar tërësinë e dokumentacionit që dispononte kjo dosje.

Në këtë mënyrë në rast të ndonjë humbje aksidentale apo të qëllimshme të dokumentacionit bëhej e pamunduar identifikimi i humbjes së tij dhe personat përgjegjës për humbjen e dokumentacionit.

Mospajisja e dosjeve me një procesverbal, rrezikon humbjen e ndonjë të dhëne, ndoshta dhe sensitive të pacientit, për pasojë dhe keqpërdorimin dhe rënien e këtij dokumentacioni në duar të personave të pautorizuar. Marrja e masave për të siguruar që ky dokumentacion të shoqërohet vetëm nga personat e autorizuar është një detyrim ligjor i kontrolluesit.

Për të siguruar mbrojtjen e të dhënave personale, është e nevojshme që nga kontrolluesi të merren masa të përshtatshme, jo vetëm në lidhje me aktivitetet e zakonshme të shërbimit të kujdesit shëndetësor, si kontrollues i të dhënave personale, por, gjithashtu duhen marrë masa edhe për cdo veprim individual që përfshin të dhëna personale, veprime të tilla si përcjellja e dokumentave shëndetësore në vende të tjera, ose nga një person tek një tjetër.

- Në këtë rast nuk është zbatuar neni 27 i ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “*Për mbrojtjen e të dhënave personale*”. “*Kontrolluesi ose përpunuesi merr masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave bëhet në rrjet, si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi*” dhe Udhëzimit nr. 5, datë 26/05/2010, pika 12 “*Për rregullat themelore në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale në sistemin e kujdesit shëndetësor*” të Komisionerit Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ...“*Në lidhje me komunikimin (zbulimin) e informacionit të pacientit janë të detyrueshme rregullat si më poshtë:*

*- Informacioni i pacientit duhet të ruhet në formën që mbron sa më mirë identitetin e pacientit nga zbulimi i këtij informacioni tek personat e tjerë të paautorizuar”.*

Pajisja e dosjeve që mbahen në arkivë, me procesverbalet përkatëse, të cilat evidentojnë dokumentacionin që këto dosje disponojnë është gjithashtu një detyrim ligjor i parashikuar edhe në ligjin nr. 9145, datë 06.11.2003 “ Për arkivat”, me ndryshimet përkatëse.

5. U konstatua se, kontrolluesi Spitali Amerikan **UNIVERS-ALB Sh.A**, në lidhje me Formularin e Aplikimit për Punë grumbullon dhe ruan të dhëna, që tejkalojnë qëllimin, në këtë rast, **atë të punësimit**. duke shkelur kështu, nenin 5/c të Ligjit Nr. 9887, dt.10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i cili shprehet: ”...*të dhënat duhet të jenë të mjaftueshme, të lidhen me qëllimin e përpunimit dhe të mos e tejkalojnë këtë qëllim;*”.

Sa më sipër, vlerësojmë se: disa të dhëna personale të aplikantëve, kërkuar nga Spitali Amerikan nëpërmjet Formularit të Aplikimit për Punë janë të tepërta, të tilla si:

- **fotoja**, - pasi jo domosdoshmërisht fotoja dhe identifikimi i subjektit nëpërmjet fotos është një kriter për punësim, sidomos në fazën e parë të seleksionimit dhe nuk i shërben qëllimit për të cilin kjo e dhënë duhet të mbledhet. Kjo e dhënë mund të administrohet në dosjen personale të të punësuarit në një periudhë të mëvonshme dhe jo që në fazën e aplikimit, identifikimi i personit mund të bëhet në fazat e mëvonshme të seleksionimit të kandidatëve për punësim);
- **vendlindja** - nuk ka lidhje me qëllimin e aplikimit, nuk i shërben qëllimit për punësim dhe për seleksionimin në fazën e parë nëpërmjet aplikimit, përveç se zbulon origjinën e aplikantit, nuk nxjerr të dhëna të tjera për punësim.
- **gjendja civile** - e cila mund të jetë opsionale, nuk lidhet në qëllimin e punësimit dhe evidentimin e aftësive të aplikantit. Kjo mund të jetë një dhënë e kërkuar nga zyra e punës dhe mund të jepet për qëllime statistikash tek kjo zyrë, por nuk i shërben qëllimit për punësim të aplikantit);
- **arsyeja e largimit** - në rubrikën “Eksperiencia pune”, kjo mund të jetë një e dhënë që mund të verifikohet në fazat e mëvonshme nga punëdhënsi, nuk është e nevojshme të merret që në fazën fillestare të aplikimit.
- **Sëmundjet dhe operacionet që keni kaluar ose jeni duke kaluar** - në rubrikën “Gjendja shëndetësore, të bëhet opsionale, jo për të gjithë punonjësit është e nevojshme të dihet se çfarë sëmundjesh ka kaluar.
- **penalitetet, nëse po, shpjegoni arsyen-** mund të verifikohet në fazat e mëvonshme nga punëdhënsi, Spitali Amerikan, nuk është i nevojshëm që në fazat e para të aplikimit.
- **rekomandime, Nr i telefonit** - Nr. i telefonit të rekomanduesit është e dhënë e tepërt, mënyra e kontaktit me rekomanduesin mund të vendoset vetëm nëse ky

numër telefoni është bërë i njohur publikisht, (psh. nepërmjet faqeve të internetit, nëse është institucion zyrtar). Por, edhe në këtë rast, nëse numri është i njohur publikisht, kontrolluesi mund ta gjejë mënyrën e kontaktit, pa marrë deklarin e aplikantit.

Gjithashtu, pëlqimi për dhënien e numrit të telefonit, mund të jepet vetëm nga personi që është mbajtës i këtij numri dhe jo nga një person tjetër. Sipas Nenit 6 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “ Për mbrojtjen e të dhënave personale “ *Të dhënat personale përpunohen vetëm: a) nëse subjekti i të dhënave personale ka dhënë pëlqimin*; Sipas nenit 3 të ligjit të sipërcituar, *“Pëlqim” është deklarata specifike, e dhënë me vullnet të lirë nga subjekti i të dhënave personale për përpunimin e të dhënave të tij*”. Pra, dhënia e pëlqimit është personale, duhet të jepet vetëm nga mbajtësi i nr, të telefonit në këtë rast, duhet të jepet në mënyrë specifike.

Duke qënë se, formulari i aplikimit nuk plotësohet vetëm online por edhe dorazi, kontrolluesi nuk ka kontakt me aplikantin në këtë fazë,( si fazë para- seleksionuese) dhe në këto kushte nuk verifikon dot, nëse aplikanti ka marrë ose jo –pëlqimin e rekomanduesit.

Kontakti me rekomanduesin dhe verifikimi i dhënies së pëlqimit nga ana e tij për kontakt me të, nëpërmjet numrit të telefonit, mund të bëhet në fazat e mëvoshme. Sa më sipër, kjo është një e dhënë e tepërt dhe duhet hequr nga formulari aplikimit për punë.

Në fund të Formularit të Aplikimit parashikohet : ” Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të njoftohen për intervistë. Aplikimi dhe të gjitha dokumentat shoqëruese mbeten në pronësi e Univers- Alb sh.a dhe nuk mund të kthehen” .

- Ky parashikim është në kundërshtim me nenin 5, pika 1 shkronja “d” të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të dhënave personale”, **Mbrojtja e të dhënave personale bazohet:** “d) në mbajtjen në atë formë, që të lejojë identifikimin e subjekteve të të dhënave për një kohë, por jo më tepër sesa është e nevojshme për qëllimin, për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar më tej “.

Në zbatim të kësaj dispozite, të dhënat personale që mblidhen nëpërmjet formularit të aplikimit duhet të mbahen për aq kohë sa është e nevojshme për qëllimet e seleksionimit, të punonjësit në fazat e mëvonshme për punësim. Në rast se punonjësi nuk seleksionohet, atëherë humbet qëllimi për të cilin janë mbledhur këto të dhëna dhe në këtë mënyrë mbajtja e këtyre të dhënave në mënyrë të papërcaktuar përbën shkelje të ligjit të sipërcituar.

Gjithashtu, një parashikim i tillë është në kundërshtim me nenin 12, e drejta për akses “ Çdo person ka të drejtë që, me kërkesë me shkrim, të marrë nga kontrolluesi:

- a) *konfirmimin nëse të dhënat personale po i përpunohen ose jo, informacion për qëllimin e përpunimit, për kategoritë e të dhënave të përpunuara dhe për marrësit e kategoritë e marrësve, të cilëve u përhapen të dhënat personale; nenin 13 , e drejta për të kërkuar korrigjimin dhe fshirjen “ Çdo subjekt i të dhënave ka të drejtë të kërkojë korrigjimin ose fshirjen e të dhënave, kur vihet në dijeni se të dhënat rreth tij nuk janë të rregullta, të vërteta, të plota ose janë përpunuar dhe mbledhur në kundërshtim me dispozitat e këtij ligjit ”.*

Pra, praktikisht nuk i lë asnjë lloj hapësire subjektit të të dhënave për të patur në vazhdim të drejta mbi të dhënat e tij personale, dhe subjekti i të dhënave nuk ka asnjë informacion se çfarë ndodh më tej me të dhënat e tij. Të dhënat personale të tij mbahen tej qëllimit për të cilin janë mbledhur. Kjo e bën kontrolluesin një mbajtës abuziv të këtyre të dhënave personale.

Kjo rubrikë është krejtësisht, në kundërshtim me dispozitat e ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të dhënave personale” dhe si e tillë duhet hequr nga Formulari i Aplikimit.

**Sa më sipër, vlerësojmë se të gjitha këto të dhëna të aplikantit për punësim, janë të tepërta dhe për më tepër nuk është asnjë nga këto të dhëna në versionin opsional, si dhe nuk kanë siguruar aplikantin se, këto të dhëna grumbullohen, mbahen dhe përpunohen sipas një ligji të posaçëm, që është Ligji, Nr. 9887, dt.10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.**

Nga ana tjetër në këtë formular duhet të shtohet, një rubrikë ku të informohet subjekti i të dhënave në përputhje me nenin 18 të ligjit, në lidhje me përpunimin e të dhënave dhe ti behen të ditura subjektit të të dhënave të drejtat e tij, sipas parashikimeve të neneve 12-17 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të dhënave personale”.

Gjithashtu, e dhënë e tepërt është edhe “Kombësia” e cila është një nga të dhënat që mblidhet nga subjektet e të dhënave “pacientë”. Kjo e dhënë nuk i shërbën qëllimit për të cilin mblidhet, pasi kombësia nuk zbulon ndonjë element të gjëndjes shëndetësore të pacientit dhe nuk lidhet me ndonjë shërbim mjekësor specifik që mund t’i jepet pacientit. Në këtë kuadër sugjerojmë që kjo e dhënë të zëvendësohet me “Shtetësinë”.

- Në këtë rast nuk është zbatuar neni 5 pika1/c i ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”... c) të dhënat duhet të jenë të mjaftueshme, të lidhen me qëllimin e përpunimit dhe të mos e tejkalojnë këtë qëllim”,...

Nisur sa më sipër në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, si dhe 107-109 të K.Pr.Administrative ;

## REKOMANDOJ

1. Në zbatim të neneve 21, 22, 23 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, kontrolluesi, Spitali Amerikan UNIVERS-ALB Sh.A, të riformulojë Formularin e njoftimit duke plotësuar të gjitha mangësitë, sipas konstatimeve të përshkruara në pjesën arsyetuese të këtij rekomandimi.
2. Në zbatim të neneve 27 të ligjit nr. 9887 datë, 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” kontrolluesi, Spitali Amerikan UNIVERS-ALB Sh.A, të hartojë rregulloren e brendshme të posaçme për mbrojtjen e të dhënave personale. Gjithashtu ky kontrollues të përcaktojë rregulla të veçanta në lidhje me kohën e mbajtjes së të dhënave, sidomos përsa i përket dosjeve të personelit që ndërpresin marrdhëniet e punës me kontrolluesin si dhe të hartojë rregulla të posaçme lidhur

me kohëzgjatjen e mbajtjes së të dhënave që sigurohet nga sistemi i kamerave të mbikëqyrjes CCTV, sidomos në lidhje me kamerat e vendosura në sallat e operacioneve, ku duhet të ketë një rregullim të vecantë.

Në zbatim të nenit 18 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “ Për mbrojtjen e të dhënave personale” të vendosen tabela informuese në të gjitha ambientet të cilat mbikëqyren me kamera (sipas modelit standart të miratuar nga Komisioneri me Urdhërin Nr. 33, datë 27.06.2011).

3. Në zbatim të nenit 5, pika 1/c, dhe nenit 18 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, kontrolluesi Spitali Amerikan UNIVERS-ALB Sh.A, në Formularin e aplikimit për punësim, të parashikojë të dhënat opsionale, të heqë ato të klasifikuara të tepërta dhe të shtojë rubrikë për informimin e subjekteve të të dhënave personale, sipas pjesës arsyetuese të këtij rekomandimi. Gjithashtu, në aplikacionin e të dhënave që mblidhen për pacientin, të hiqet rubrika “Kombësi” dhe të zëvendësohet me “Shtetësi”.

Kryerja e këtyre rekomandimeve të rëndësishme për mbrojtjen e të dhënave personale që ju ngarkon ligji të realizohet brenda një afati kohor prej dy muajsh.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

KOMISIONERI

FLORA ÇABEJ (POGAÇE)

